

NETTUNO SHPK IMPORT-EKSPORT CONSERVE ITTICHE” Sh.p.k
NIPT L42731204J

NJOFTIM

Datë 15/ 09/ 2020

Drejtuar : Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Lenda: Kërkesë për zhvillimin e procedurës së degjësës me publikun

Shoqëria “NETTUNO SHPK IMPORT-EKSPORT CONSERVE ITTICHE” Sh.p.k me NIPT L42731204J njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për zhvillimin e procedurës së informimit të publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit B për instalimin:

“Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, ID 7.7 f, Veprimtaria: Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve”, Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Të gjitha instalimet me vendndodhje në Fshatin Allprenaj, Bashkia Lushnje.


Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014 , Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” te ndryshuar, kreu VI “Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B”, bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kërkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

- a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për “**Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B**” apo
“Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”.
- b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
- c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
- d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- e) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
- f) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
- g) Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
- h) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
- i) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.

Përfaqësuesi Ligjor i Shoqërisë

“ **NETTUNO**” Sh.p.k

Salvatore Orlando



- a. Kërkesa për vendosjen në funksionim të instalimit “Linje për trajtimin, ambalazhimin dhe magazinimin e peshqve dhe nenprodukteve të tij” është për aplikim **per leje te re mjedisore te tipi B**, sipas Shtojces 1, të Ligjit Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar”,
 “Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, ID 7.7 f, Veprimtaria: Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve”,

b. TE DHENAT E EKSTRAKTIT TE QKB-SE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
 QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
 SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|------------------|
| 1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) | L42731204J | |
| 2. Data e Regjistrimit | 31/03/2014 | |
| 3. Emri i Subjektit | NETTUNO SHPK IMPORT-EKSPORT CONSERVE ITICHE | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 27/03/2014 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 27/03/2014 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Elbasan Elbasan ELBASAN Lagjia 5 Maj, rruga Mahmut Biçaku, Kompleksi Doko, kati 1 Elbasan, Shqipëri. | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 100,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Shitje me shumice e produkteve me origjinë shtazore, import-eksport i të gjitha produkteve me origjinë nga deti si dhe të akuakultures si të gjitha llojet e peshkut dhe nenproduktet e tij, të gjitha llojet e guackave, të gjitha llojet e specieve me origjinë detare në gjendje të freskët, të ngrirë, të kripura, të marinuara në vaj, në salce, në vakum, të konservuara etj, import-eksport i produkteve agrikulures fruta perime si të freskëta dhe të konservuara, import eksport i materialeve të ndertimit, makineri dhe pajisje. Fasoneri ose regjim të peprunimit aktiv. | |
| 10. Administratori/ët | Salvatore Orlando | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 27/03/2014 | Deri: 27/03/2024 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | Salvatore Orlando | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 100.000,00 | Natyre: |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | |
|--|---|
| 12.2 Numri i pjesëve | 100,00 |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i> | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Durres Durres DURRES Durres, zona kadastrale 8515, nr pasurie 1/286, volumi 8, faqe 239, adresa e pasurise Shkozet/14. Fier Lushnje LUSHNJE Zona kadastrale nr.1020, nr pasurise 182/50, volumi 4, faqe 78, adresa e pasurise Allprenaj, Lushnje. |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: NETTUNO SHPK IMPORT- EKSPORT CONSERVE ITTICHE E-Mail: finanzanettunoshpk@gmail.com Telefon: 0674524519 |
| 15. Statusi: | Aktiv |

Datë: 22/09/2020


Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

c. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

| Emri i instalimit/impianit ¹ | Trajtim, ambalazhim dhe magazinim i | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|---|------------|---|---|---|------------|------------|---|------------|------------|---|------------|------------|---|------------|------------|
| Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti | Fshati Allrapaj ish-fabrika e tullave, Bashkia Lushnje. | | | | | | | | | | | | | | | |
| Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4  | <p style="text-align: center;"><u>Koordinatat Gauss-Kruger</u></p> <table border="1" data-bbox="987 594 1425 814"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>X</th> <th>Y</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>4390732.22</td> <td>4537308.39</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>4390791.37</td> <td>4537276.91</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>4390714.39</td> <td>4537157.37</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>4390658.08</td> <td>4537193.02</td> </tr> </tbody> </table> | Nr | X | Y | 1 | 4390732.22 | 4537308.39 | 2 | 4390791.37 | 4537276.91 | 3 | 4390714.39 | 4537157.37 | 4 | 4390658.08 | 4537193.02 |
| Nr | X | Y | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | 4390732.22 | 4537308.39 | | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | 4390791.37 | 4537276.91 | | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | 4390714.39 | 4537157.37 | | | | | | | | | | | | | | |
| 4 | 4390658.08 | 4537193.02 | | | | | | | | | | | | | | |
| Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi ² | “Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, ID 7.7 f, Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve”, | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kapaciteti i projektuar | Kapaciteti prodhues – 50ton/muaj | | | | | | | | | | | | | | | |

¹ Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

² Shkruani kodet e specifikuar në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.



d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET

| | |
|-----------------------|---|
| AKTIVITETI: | Trajtim, ambalazhim dhe magazinim i peshqve dhe nenprodukteve tij |
| Vendndodhja | Fshati Allrapaj ish-fabrika e tullave, Bashkia Lushnje. |
| Subjekti: | “NETTUNO SHPK IMPORT-EKSPORT CONSERVE ITTICHE” Sh.p.k |
| Administrator: | Z. Salvatore Orlando |

□ Hyrje

Profili i subjektit “Nettuno” Sh.P.K per aktivitetin Trajtim, ambalazhim dhe magazinim i peshqve dhe nenprodukteve te tij.

Instalimi Trajtim, ambalazhim dhe magazinim i peshqve dhe nenprodukteve te tij të subjektit “Nettuno” Sh.P.K ndodhet ne Fshatin Allprenaj, Bashkia Lushnje, pergjate nje rruge ekzistuese e cila lidh Fshatin Allprenaj me qytetin e Lushnje. Kjo eshte nje zone me karakter multifunksional. Pra ka banesa, zhvillohet ekonomi bujqesore por edhe industri e lehte. Ky subjekti është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për aktivitetin me objekt :

Shitje me shumice e produkteve me origjine shtazore,import- eksport i te gjitha produkteve me origjine nga deti si dhe te akuakultures si te gjitha llojet e peshkut dhe nenproduktet e tij,te gjitha llojet e guackave,te gjitha llojet e specieve me origjine detare ne gjendje te fresket,te ngrire,te kripura,te marinuara ne vaj,ne salce,ne vakum,te konservuara etj,import-eksport i produkteve agrikultures fruta perime si te fresketa dhe te konservuara,import eksport i materialeve te ndertimit,makineri dhe pajisje. Fasoneri ose regjim te peprunimit aktiv.

Objekti ku ushtrohet aktiviteti per trajtimin, ambalazhimin dhe magazinim e peshqve dhe nenprodukteve te tij eshte ekzistues, ne pronesi te Shoqerisë "HIGH TOWERS"sh.p.k, nga te cilet shoqeria “NETTUNO” Sh.p.k ka merre me qera siperfaqen prej 10.000 m² truall+ndërtesë sipas Kontrates se Qirase Nr. 3021 Rep, Nr.1638/3 Kol, bere me date 13.09.2019 me afat 8 vjecar.

Objekti disponon hapsira te mjaftueshme per zhvillimin e te gjitha proceseve teknologjike per trajtimin, ambalazhimin dhe magazinimin e peshqve dhe produkteve te detit, duke i ndare ato ne sektore te vecante, sipas natyres se punes.

Sierfaqja ku zhvillohet aktiviteti eshte 10000 m².

Informacion mbi subjektin “Nettuno” sh.p.k

Subjekti “Nettuno” sh.p.k zhvillon aktivitetin e tij ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e Import-Eksport I peshkut, perpunim I peshkut dhe I nenprodukteve te tij.

Qëllimi i firmes ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise se produkteve te peshkut dhe detit, si dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj.

Per kete qellim, subjekti “**Nettuno**” sh.p.k referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” ka plotësuar Formularit e Kërkeses per tu pajisur me Leje Mjedisit te Tipit B per aktivitetin Trajtim dhe magazinim i peshqve dhe produkteve te detit .

Qëllimi i këtij aktiviteti është trajtimi, ambalazhimi, konservimi dhe magazinimi i perkohshem, tregtimin me shumice dhe pakice i peshqve dhe produkteve te detit, duke furnizuar me produkte cilesore tregun vendas dhe te jashtem .

□ **Të dhëna mbi impiantin e instaluar**

Subjekti “**Nettuno**” sh.p.k si firmë me aktivitet në fushën e trajtimit, ambalazhimit, konservimit dhe magazinimit e perkohshem, tregtimit te peshqve dhe produkteve te detit, ka investuar dhe disponon impiantet/makineritë e domosdoshme për zhvillim e proceseve kryesore.

Përshkrimi lidhur me kete sipërmarrje .

Kjo sipërmarrje konsiston ne perpunim, transformim dhe konservim nen kripe, nen vaj, marinim, tymosje dhe tharje te prodhimeve te detit, import-eksport te prodhimeve te detit, realizimi dhe menaxhimi I impjanteve te transformimit te peshkut (marikultura intensive dhe semiintensive, akuakultura ne kosha lundruet etj.

1. Qëllimi kryesor i kompanise eshte te ofroje produkte cilesore, me cmime konkurruese te cilat do te shiten ne tregje nderkombetare, duke filluar nga Italia e me gjere. Keto jane produkte artizanale dhe kane nevojte per nje trajnim dhe kualifikim te gjere te punonjesve ne menyre qe gjithcka te jete sipas shijes dhe preferencave te konsumatoreve. Ky trajnim do te realizohet nga specialistet e shoqerise te cilet jane te kualifikuar per kete proces.

2. Prodhimet e shoqerise mund te perdoren nga konsumatore perfundimtare (arsye konsumi vetjak) apo industrial te cilet I marrin produktet me qellim rishitje apo perfitimi, (tregtare te prodhimeve te detit, restorante,etj).

3. Perfitimet unike te produkteve te kesaj kompanie jane:

Cilesia e larte bazuar ne nje experience te gjere, peshku I fresket I cili do te merret cdo dite nga peshkarexhet e licensuara te cilat operojne ne zonen Vlore, Himare, Sarande, Durres.si dhe nga furnitore te licensuar te tregut europian

a) Teknologjia

Teknologjite e përdorura për prodhimin e produktit janë të rëndësishme për të diferencuar produktin nga konkurrentet (mund të përmendim akuakulturën në kosha lundrues, etj). Ky biznes vlerëson prodhimin me teknologji të sofistikuar pasi janë më produktive dhe kosto të minimizuara

b) Personeli

Personeli është çelësi i suksesit në një kompani, prandaj kjo kompani i kushton rëndësi të madhe marrëdhënies punë-menaxhim. Përmendim:

- specialistet e prodhimit të cilët janë shtetas italianë dhe kanë si detyrë të realizojnë procesin e prodhimit dhe të kualifikimit të punëtorëve.
- drejtuesi teknik i cili monitoron procesin e punës nga hyrja në repart, kontrollin e kushteve të higjenes dhe sigurisë e deri në fund të procesit të prodhimit.
- Menaxheri i cili mbikqyr punën dhe jep udhëzimet e nevojshme, kujdeset për marketingun, furnizimin me lëndën e parë, materialet ndihmëse, etj
- ekonomisti që do të mbajë pasqyrat e nevojshme financiare në lidhje me ecurinë e biznesit, bashkëpunimin me bankat, tatimet etj
- Punëtorët të cilët do të merren me pastrimin e peshkut, marinimin, konservimin, etj
- Sanitarët etj

Një rol i rëndësishëm do të ketë marketingu me qëllim rritjen dhe forcimin e biznesit. Shoqëria do të marrë pjesë në të gjitha panairët në nivel kombëtar e ndërkombëtar për të ndervepruar me shoqëri të tjera në këto fushë, për të zgjeruar aktivitetin e saj. Kjo do të vazhdojë gjatë gjithë kohës duke reklamuar produktin, apo duke marrë pjesë në panairë e konventa, etj

Përshkrim i prodhimit/shërbimit të shoqërisë.

Procesi i prodhimit fillon me blerjen e produkteve të freskëta nga furnitori që do të mëngjes dhe transportimi i tyre në repart. Aty do të nënshtrohen kontrollit nga drejtuesi teknik në lidhje me kushtet e akullimit nëq ka akoma nevojë do të trajtohet me tejt me akull dhe me pas do të vendoset në dhomë frigoriferike. Me pas kalon në tavolinat e përpunimit ku pastrohet dhe vazhdon trajnimin sipas standardeve të punës.

Disa procese punë që mund të përmendim janë përpunimi, transformimi dhe konservimi nën kripe, në vaj, marinimi, tymosja dhe tharja të prodhimeve të detit. Ambalazhimi do të jetë metalik (konserva) dhe plastikë. Ambalazhet do të merren të gatshme nga një kontraktor, pra nuk do të ketë linjë të prodhimit të tyre.

kg dhe etiketimi, apo imazhi sipas kërkesës së klientëve.

Si menaxhohet siguria ushqimore

Ky biznes i kushton një vëmendje të vecantë kushteve të punës pasi ka të bëjë me ushqimin. Siguria fillon që nga planimetria e godinës ku ushtrohet aktiviteti, veshja e uniformave nga personeli (përparesë, doreza, kapele) ndarja e zonave me etiketime të sinjalistike të qarta për ambientet e magazines, prodhimit etj, vendosja e koshave për grumbullimin e mbeturinave në pozicione të caktuara, sigurimi i temperaturës së nevojshme të produkteve në magazine, trajnimi i personelit për sigurinë ushqimore, sigurimi i certifikatave të analizave shëndetësore, higjieno-sanitare, etj, dritaret të pajisura me rrjeta mbrojtëse nga insektet, vendosja e ndricimit të duhur në zonat operative, sistemimi i zonës së ruajtjes së kripës, monitorimi i lageshtisë së temperaturës, fikset e zjarrit në ambiente të ndryshme të fabrikës.

PERSHKRIMI I PROCESIT TË PERPUNIMIT

Procesi i përpunimit nën kripe:

1 – Hyrja e produktit të freskët

- 2 – Larja e produktit në tretesire me kripe (shellire)
- 3 – Prerja e kokës dhe heqja e të përbrendshmeve
- 4 – Larje e mëtejshme në shellire
- 5 – Kriposje
- 6 – Shtypje dhe stazhionim/maturim
- 7 – Konfeksionim i produktit të kripur
- 8– Amballazhim dhe konservim i prodhimit të përfunduar dhe dalje e mëtejshme drejt tregëtimit
- 9 – Etiketimi

1 – Hyrja e produktit të freskët

Prodhimi, i stivuar në arka druri, polisteroli ose plastike, blihet në peshkatar të ndryshëm. Arkat që vijnë nga një ose më shumë anije peshkimi, mbërrijnë në kohën më të shkurtër të mundshme në fabrikë, nëpërmjet transportimit në automjete të posacme të pajisur me frigorifer, ku i nënshtrohen menjëherë përpunimit. Përcaktohet që nëse prodhimi del nga ftohja në këtë fazë të procesit ai duhet kthyer pas.

2 – Larje e prodhimit në shellire

produkti transferohet në brendësi të mbajtëseve të posacme ku i nënshtrohet një faze larje në shellire në pritje të fazës pasardhëse.

3 – Prejra e kokës dhe heqja e të përbrendshmeve

Pas një larjeje në shellire përpunohet në tavolina të prerjes së kokës dhe heqjes së të përbrendshmeve. Në këtë fazë, i hiqet koka dhe të breshmet, pas kësaj faze, seleksionohet dhe ndahet për peshë, në bazë të nevojave tregtare për të kaluar më pas në një fazë të mëtejshme larjeje në shellire.

4 – Larje e mëtejshme në shellire

Në këtë fazë, i nënshtrohet një faze të mëtejshme larjeje në shellire, për të kaluar më pas, në kriposjen reale. Larja me shellire behet qe te ruhen vlerat ushqimore.

5 – Pas larjes me shellire, stivohet në fuci me kapacitet të ndryshëm, në fundin e të cilave depozitohet një shtresë kripe e hollë me trashësi rreth 1cm. Kësaj i mbivendoset një shtresë produkti, një shtresë tjetër kripe me trashësi më të vogël e kështu me rradhë derisa produkti të fryjë mbjatësen e përdorur, duke përdorur me qëllim mbajtjeje një shtresë/veshje të hollë plastike që ka një diametër lehtësisht më të vogël se ajo e enës mbajtëse. Në shtresën e fundit të peshkut vendoset një shtresë e mëtejshme kripe dhe në fund fare një kapak druri i vendosur me presion spastrimi, ne kulmet e të cilit vendosen pesha me përdorim zavorra për të garantuar shtypje uniforme të prodhimit.

6 – Shtypje dhe stazhionim/maturim

Pas fazes së kriposjes ndodh faza e stazhionimit ose maturimit të produktit. Përgjatë kësaj faze, në enët mbajtëse vendoset një shtresë kripe e trashësisë 2cm, vendoset në kapakun prej druri, dhe enet mbajtëse sistemohen në mënyrë të tillë që të formojnë “kulla maturimi”. Në mënyrë periodike realizohet ajo që quhet “larja e kullave”, e cila konsiston në ujitje të kullave me shellire, me qëllim qe te favorizojë spastrim të enës mbajtëse. Në kulmet e kullave vendosen pesha për të shtypur peshkun dhe për të thjeshtësuar në këtë mënyrë

eliminimin e yndyrnave dhe të ujit që përmbahen nga mishi. Cdo javë merren masa që të ndryshojë pozicionimi i enëve mbajtëse duke lëvizur poshtë ato të shtresave më të larta dhe duke ngritur lartë ato të shtresave të poshtme, në këtë mënyrë ushtrohet presion i njetrajtshëm në të gjithë masën e prodhimit. Konfeksionet duhet të jenë në vazhdimësi të ujitura me shellire për të evituar që shtresat e sipërme të peshkut të hyjnë në kontakt me ajrin e të mund të pësojnë fenomene oksiduese të padëshiruara. Procesi i maturimit zgjat në tërësi rreth 45 ditë, por kohëzgjatja ndryshon në bazë të llojit dhe temperaturës së ambientit.

7 – Konfeksionimi i produktit të kriposur

Në përfundim të periudhës së maturimit, pra kur produkti merr një ngjyre, një konsistencë dhe një shije karakteristike, produkti mund t'i nënshtrohet procesit të sfiletimit ose mbylljes dhe hedhjes në treg. Në këtë rastin e fundit, kripa dhe shellire zëvendësohen, kanacet ose arkat mbyllen dhe hidhen në treg.

Faza e mbylljes mund të realizohet nëpërmjet punës me dorë ose nëpërmjet makinerive të posacme të quajtura qepëse.


8 - Amballazhim dhe konservim i prodhimit të përfunduar dhe dalje e mëtejshme drejt tregtimit. Në këtë pikë, enët mbajtëse mbyllen, etiketohen dhe vendosen në shitje ose janë të destinuara për “procesin e filetimit”. Në përgjithësi prodhimi tregtohet në enë mbajtëse kanace prej 1, 2, 5 dhe 10 kg ose në enë mbajtëse të përbëra prej materiali plastike që shkojnë nga 1kg deri në 300kg.

9 – Etiketimi

Pas mbylljes, prodhimi etiketohet duke përmbajtur të gjitha informacionet e parashikuara nga ligjet në fuqi (vendi i prodhimit, pesha neto dhe e perpunuar, mënyrat e konservimit të konfeksionit, perenca apo jo e konservuesve, vendi I peshkimit, kushtet e fabrikës së përpunimit, fabrika e përpunimit, prezenca e alergjenëve, mënyra e peshkimit, zona e kapjes, etj).

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti perpunimit dhe konservimit te peshkut jane ato organike te tilla si skeleti prej kocke, kokat e peshkuat, luspa, zorre dhe papasterti te tjera. Subjekti keto mbetje duhet ti grumbulloi ne ene te posacme , ti thaje dhe ti tregetoi tek te trete. Keto mbetje riciklohen ne fabrikat e miellezimit qe sherbejne si ushqim per kafshet.



Skema teknologjike

PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- **INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;**

“Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, ID 7.7 f, Veprimtaria: Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve”, Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Të gjitha instalimet

- **LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;**

Lendet e para që perdoren janë”

- Peshq dhe produkte të tjera të detit
- Kripe
- Uje
- Energji Elektrike

- **BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI;**

Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

| Nr. Referencës së pikës së shkarkimit | Sh1 |
|---|--|
| Burimi i shkarkimit | Operacionet e trajtimit dhe magazinimit të peshqve dhe produkteve të detit |
| Përshkrimi | Aromat e gjeneruara |
| Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4) | X: 4390658.08 Y: 4537193.02 |
| Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m) | N/A Nuk ka oxhak |
| Data e fillimit të shkarkimeve | |

Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve (një faqe për çdo pikë të shkarkimeve)

| | |
|---|--|
| Nr. Ref. i pikës së shkarkimit: (numri i referencës duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit) | K.1 |
| Vendndodhja e pikës së shkarkimit rrjetin e kanalizimeve | Kolektori kryesor i rrjetit të brendshëm të kanalizimeve |
| Koordinatat (për efekt të vlerësimit të ndikimit) | X : 4390714.39 Y : 4537157.37 |

| | |
|---|---|
| Emri i kompanisë e cila menaxhon sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura | “Nettuno” Shpk |
| A është sistemi i kanalizimeve i lidhur me një impiant trajtimi? | |
| Emri i mjedisit përfundimtar uxor pritës të ujërave të ndotura nga rrjeti i kanalizimit (estuar, lumë ose mjedis tjetër uxor pritës dhe ndikimi në të i cili duhet kontrolluar) | Rrjeti i kanalizimeve të Bashkisë Lushnje |

Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

| Burimi i shkarkimit | Nr. Ref. i pikës së shkarkimit | Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE 4 | Nr. Ref. i pajisjes që gjeneron ndotje akustike | Presioni akustik ¹ (dBA) duke ju referuar distancës | Periudha e shkarkimit |
|--|--------------------------------|---|---|--|-----------------------|
| Proceset e ngarkimit, shkarkimit të lëndës së pare | 1 | X: 4390791.37 Y: 4537276.91 | | 57 | 20 minuta ne ore |
| | | | | | |
| | | | | | |

- KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES;

Zona ku do të zhvillohet aktiviteti ndodhet në Fshatin Allrapaj ish-fabrika e tullave, Bashkia Lushnje.

□ **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE**
Mjedisi është gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jete i ndryshem, kjo është e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund të ketë impakt të drejtperdrejte, të terthorte, të rëndesishem apo mesatar i pranueshem.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në teresi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kesaj zone do të vleresohen në njeren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti është i ndertuar dhe ndikimi në mjedis do të jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive në magazinën e peshqeve dhe produkteve të detit. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarise pasi ky projekt do të vazhdojë të jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vleresuar si të mundshme janë paraqitur si më poshte. Efektet e mundshme nga aktiviteti që ushtrohet do të vleresohen në menyre të pergjithshme në kete formular për pajisjen me leje mjedisi tipi B. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme në kete fushe.

- **Impakti ne mjedis i ketij aktiviteti dhe menaxhimi i tij**

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me aktivitetin e trajtimit, konservimit, paketimit dhe magazinimit te peshqve dhe produkteve te tjera te detit, gjate fazes operative sebashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit. Shkarkime ne uje

Ujerat qe dalin nga aktiviteti trajtimit dhe magazinimit te peshqve dhe procesit te larjes se ambienteve te magazines jane ujera me permbajtje yndyre, fosfori dhe nitrati, lende ne pezulli, ujera me permbajtje detergjenti, etj. Keto ujera shkarkohen ne kolektorin kryesor te ujerave te perdorura, me pas kalojne ne vaska dekantuese, e me tej shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones industriale. Nuk ka impiant trajtimi te ujerave te perdorura.

Ne baze te shtojces nr.3 e VKM Nr.177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, vlerat e lejuara per ujerat e shkarkuara nga disa sektore industriale ne mjediset prites ujore:

| Spektori industrial | Parametrat | Vlerat e lejuara |
|---------------------------------|---|---|
| 1 | 2 | 3 |
| Trajtim dhe magazinim i peshqve | pH Lendet ne pezulli BOD5 COD Yndyrat Nitrati total Fosfori total | 6-9 50 mg/l 50 mg/l 250 mg/l 10 mg/l 10 mg/l 5 mg/l |

Emetimet ne ajer

Nga zhvillimi i aktivitetit per trajtimit, konservimit, paketimit dhe magazinimit te peshqve, nuk kemi shkarkime ne ajer, pervec aromave te cilat eshte e veshtire te behet vleresimi i tyre dhe aroma eshte pothuajse e pranishme edhe nese nuk do kishim zhvillimin e ketij aktiviteti.

Zhurmat dhe vibrime

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga perdorimi i mjeteve te transportit te magazinimit te lendeve te para te produkteve te peshkut, zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete aktivitet, sistemi i aspirimit-kondicionimit. Punëtorët nuk ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin megjithate edhe ne situata te tjera ku niveli eshte me i larte se normat e lejuara ne mjediset e punes, punonjesit mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa nuk do te jene te nevojshme. Nuk shkarkohen vibrime

Ndikimi ne toke

Proceset e punes per kete lloj aktiviteti nuk ndikojne ne toke, kjo per shkak te shtrimit te shesheve si te brendshme dhe te jashtme me shtresa te pa depertueshme nga uji apo solucione te ndryshme kimike. Ky aktivitet nuk ka ndikuar ne zenien e tokes se re ne asnje faze te tij. Aktiviteti eshte ngritur ne Bashkine Orikum, Vlore. Nuk demtohet bimesia e zones, nuk demtohet relievi as struktura e tokes.

Ndikimi ne Biodiversitet

Aktiviteti ndodhet ne nje zone ku nuk ka prekur mjedisin natyror, por gjithesesi, shkarkimi i ujerave te procesit te trajtimit dhe magazinimit pa u trajtuar, shoqerohet me ndikime te rëndesishme ne mjedisin/biodiversitetin e burimeve ujore te zones.

Ndikimi ne Mjedisin Social

Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, do te jete pozitiv persa i perkete punesimit, por jo vetem.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe prodhohen jane ambalazhet e ushqimeve, Mbetjet urbane nga aktiviteti human, te cilat grumbullohen ne kosha te posacem dhe largohen per ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones (mbetje te parrezikshme, me kodin pa Yll) 20 01 01 “Mbetjet urbane”. Gjithashtu gjenerohen edhe mbetje nga proceset e proceset e pastrimit.

- **TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME;**

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

| Rekomandime për zbutjen e ndikimeve | |
|--|--|
| Toka | |
| Përdorimi i Tokës | Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve. |
| Biodiversiteti | |
| Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit | Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve te rinj, pergjate rruges qe ben te mundur hyrjen per ne objekt. |
| Cilësia e ajrit | |
| Rritje e emetimeve ne ajer nga djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit | Mjete me kolaudim optimal. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorim i karburanti cilësor per automjetet e transportit. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. |

| | |
|---|--|
| Sistemi i brendshem i grumbullimit te ujrave | |
| Sistemi i brendshem | Mirembajtja e sistemit të grumbullimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike te pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaskat e dekantimit. |
| Mbetjet | |
| Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt. | Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia vendore. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim ne maksimum i mbetjeve te gjeneruara, si dhe nga pastrimi i vaskave te dekantimit. Mbetjet e gjeneruara nga proceset e trajtimit dhe magazinimit te peshqve (mbetje te paperdorshme) grumbullohen dhe rikuperohen nga subjekte te licencuara. |
| Ujërat e Ndotura Urbane | Trajtimi i ujrave te perdorura teknologjike, duke i derguar ne vaskat e dekantimit, ku i neshtrohen procesit te trajtimit fizik, precipitimi i lendeve pezull dhe hollimi i tyre me uje. |
| Zhurmat | |
| Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve | Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Zhvillimi i aktivitetit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme. |
| Trafiku rrugor | |
| Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve | Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor. |

- Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.
- Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambjent të vecuar kështu që nuk do ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth. Do të behet pajisja e punonjësve me mjete mbrojtëse personale.
- Subjekti ka ndertuar një sistem të grumbullimit të ujrave teknologjike dhe ujrave sipërfaqësor dhe devijimit të tyre në vaskat e dekantimit.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
- Nuk kemi gjenerimin e Mbetjeve të rrezikshme.
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kazan të vecantë. Kontenieret do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Njësia Vendore për mbetjet urbane. Mbetjet e paketimit dhe mbetjet teknologjike që dalin nga proceset e trajtimit, konservimit dhe magazinimit të peshqveve do të mbledhen dhe dorëzohen në kompani të licensuar për përdorimin, riciklimin apo trajtimin e tyre.

- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.

Masa lehtësuese të tjera të kerkuara

Është mundësuar një menaxhim sa më eficient të energjisë elektrike, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive me efikasitet.

Percaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.

Masa për sigurimin teknik dhe mbrojtja në punë

Aktiviteti i subjektit “**Nettuno**” Shpk praktikisht nuk përben rrezik për stafin e saj për arsye të investimeve të koheve të fundit në instalimin e pajisjeve të reja e moderne, kushteve me strikte të emergjencës, mirëmbajtje nepermjet ekspertëve dhe teknikeve të pajisjeve, veshjeve mbrojtëse të punonjësve, etj.

Pajisjet e reja janë me të avancuara dhe një sërë veprimesh i kanë të automatizuara duke shmangur kështu nderhyrjen e punonjësve dhe të punuarit pranë tyre, për veç të tjerash shoqëria ka disa rregulla strikte të cilat zbatohen me rigorozitet për mos nderhyrjen në makineri gjatë punës, stakimit të energjisë para fillimit të kontrollit apo mirëmbajtjes e remontit të tyre, etj.

Rekomandimet për të parandaluar, minimizuar dhe kontrolluar rrjedhjet nga depozitimi i lëndës së parë (peshqve dhe produkteve të detit) përfshin:

- Kontrolli i rrjedhjeve të shkaktuara nga lëndet e para, nepermjet përdorimit të sipërfaqeve të papershkrueshme.
- Shkarkimi i lëndeve të para duke respektuar me rigorozitet kushtet teknike dhe brenda koordinatave të percaktuara për depozitimin dhe ruajtjen e tyre, për aq kohë sa ato do të vendosen në punë.
- Grumbullimi dhe trajtimi fizik i ujërave nepermjet vaskës së dekantimit

Për më tepër rekomandimet për të parandaluar dhe kontrolluar rrezikun e ndotjes përfshijmë:

- Mbetjet urbane të grumbullohen transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara nga Njësia Vendore.
- Të realizohet ndriçimi përreth (vendosja e impiantit të ndriçimit).
- Të kryhet rregullimi i territorit në përputhje me kondicionet urbane të percaktuara.
- Subjekti të operojë në përputhje të plote me normat që janë në fuqi, dhe të kryej monitorime të vazhdueshme të tregueseve mjedisor të trysnise në mjedis.
- Të respektoje të gjitha rregullat e mbrojtjes kundër zjarrit gjatë operimit në ndertese dhe të respektoje rregulloren e MKZ.
- Të instalohen dhe të respektohen sinjalistikat e trafikut të cilat do të minimizojnë impaktin për aksidente të mundshme.
- Për të minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, të limitohen proceset e zhurmshme gjatë orëve me të ndjeshme.
- Të respektoje të gjitha masat e percaktuara në këtë Formular Kerkese për tu pajisur me Leje Mjedisore Tipi B.

- Te respektoje te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e pritshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithatë perparësitë që ka ky aktivitet, duhet të tregohet kujdes në menaxhimin dhe mbajtjen nën kontroll të kushteve teknike për të minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

- ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR;

Objekti ku ushtrohet aktiviteti për trajtimin, ambalazhimin dhe magazinim e peshqve dhe nënprodukteve të tij është ekzistues, në pronësi të Shoqërisë "HIGH TOWERS" sh.p.k, nga të cilët shoqëria "NETTUNO" Sh.p.k ka marrë me qera sipërfaqen prej 10.000 m² truall+ndërtesë sipas Kontrates së Qirase Nr. 3021 Rep, Nr.1638/3 Kol, bërë me datë 13.09.2019 me afat 8 vjeçar.

- MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME); Plani i Menaxhimit të Mbetjeve

Aktiviteti që zhvillon subjekti nga proceset e ndryshme të operimit të punës në trajtimin, konservimin, paketimit dhe magazinimin e peshqve dhe produkteve të tjera të detit gjenerohet një sasi e vogël mbetjesh urbane dhe nga industria e perpunimit të peshkut (llumra nga vaskat e trajtimit).

Rrymat prioritare të mbetjeve të gjeneruara në objekt dhe nga procesi i trajtimit dhe magazinimit të peshqve, ndahen sipas fraksioneve të mëposhtme:

- Mbetje teknologjike (llumrat e pastrimit të vaskës së dekantimit)
- Mbetje të ngurta urbane (Mbetjet të ambalazhit, karton, plastik, etj)

Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve: Diferencimi i mbetjeve të gjeneruar brenda objektit të shfrytëzuar, sipas fraksioneve kryesore nëpërmjet instalimit të sistemit me 3-Kontenier, reduktimin e mbetjeve nga industria e trajtimit, konservimit, paketimit dhe magazinimit të peshqve dhe produkteve të tjera të detit, asgjësimin e mbetjeve teknologjike dhe transportimi i tyre periodik në vendin e caktuar nga Bashkia përmes bashkëpunimit me NJQV-në për firmat e kontraktuara në grumbullimin e mbetjeve urbane, në ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme në diferencimin e mbetjeve, duke maksimizuar dobinë e Landfillit Rajonal (ku kryhet dhe asgjësimi përfundimtar i tyre, sipas Strategjisë Kombëtare të Mjedisit për Menaxhimin e Mbetjeve).

Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:

- Instalimi i sistemit me 3-kontenier brenda zones ku zhvillohet aktiviteti
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare (Plastik, Letër/Karton dhe Mbetje të tjera).
- Rikuperimi, Riciklimi dhe Riperdorimi ne maksimum te mbetjeve nga industria e trajtimit dhe magazinimit te peshqve, duke rritur eficencen e vete impiantit dhe reduktimin e kostos per asgjесimin e tyre.
- Menaxhimi i mbetjeve qe dalin nga pastrimi i vaskes se dekantimit.
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendepozitimin e caktuar nga Njësia Vendore.
- Nëshkrimi i kontratave me biznesin e riciklimit për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane që gjenerohen nga aktiviteti.

Synime:

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e objektit dhe diferencimin e mbetjeve sipas tre rrymave kryesore.
- Organizimi i diferencuar i mbetjeve në përputhje me politikat kombëtare, për të mundësuar dhe stimuluar metodat e trajtimit të mbetjeve (riciklimi dhe kompostimi).
- Planifikimi dhe ngritja në nivelin zonal i një rrjeti të kontenierëve për diferencimin e mbetjeve me qëllim për të maksimizuar dobinë e Landfillit Rajonal.
- Maksimizimi i përdorimit të mbetjeve urbane
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe trajnimi i punonjësve të vetë shoqërisë, duke ofruar një efikasitet dhe efektivitet në diferencimin dhe menaxhimin të integruar të mbetjeve.

- MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

Programi i Përmirësimit të Procesit të Punës

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit për trajtimin, konservimin, paketimin dhe magazinimin e peshqve dhe produkteve të tjera të detit, mbrojtjen nga emetimet e gazrave, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të, CO₂, NO_x, SO_x në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë efikente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti ka hartuar “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme

| <i>Çfarë</i> | <i>Masat</i> | <i>Kush i zbaton</i> |
|---------------------|---|---|
| Parandalim | <ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë depozitimit, transportimit dhe përdorimit të teknologjisë. - Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme. - Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik. - Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis. | Investitori, Drejtuesi Teknik dhe punonjësit. |

| | | |
|------------------|---|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti i trajtimit dhe magazinimit të peshqve. - Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës, si : doreza, këpucë me veshje gome, veshje hiqenike, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen brenda objektit. - Grumbullimi, diferencimi dhe transportimi i mbetjeve të ngurta urbane çdo ditë në fund të procesit të punës në kontenerët e vendosur nga Njësia Vendore. - Testimi paraprak i gjithë teknologjisë (instalimeve) dhe rrjetit elektrik. - Pastrimi periodik i vendit të depozitimit të lëndës së parë, pastrimi periodik i rrjetit të brendshëm të kanalizimeve të ujrave teknologjike dhe të largës. - Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit/makinerve dhe pajisjeve - Monitorimi periodik i parametereve mjedisore dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë. | |
| Kontroll | <ul style="list-style-type: none"> - Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike - Pastrimi i rrjetit të brendshëm të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti. - Vëzhgimi dhe kulaudimi i vazhdueshëm i të gjithë teknologjisë dhe instalimeve të projektit. - Përdorimi eficient i energjisë elektrike si dhe sigurimi i ambientit të objektit me ndriçimin e duhur për zhvillimin e aktivitetit. - Diferencimi i mbetjeve sipas rrymave specifike që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve në territorin brenda dhe jashtë objektit ku ndodhet instalimi. - Monitorimi periodik i parametereve mjedisore dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë. - Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash. - Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme. | Drejtuesi Teknik dhe punonjësit. |
| Ndërhyrje | <ul style="list-style-type: none"> - Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike - Mobilizimi i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit. - Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparatura nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti. - Zëvendësimi i menjehershëm të pjesëve të pajisjeve/apaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme. - Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar. | Personeli dhe organet Shtetërore të Specializuara. |

| | | |
|--------------------|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Riparimi i menjëhershëm i teknologjisë dhe linjës së perpunimit, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve. - Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre. - Reduktimi i sasisë së ujrave të përdorura për qëllime sanitare. - Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt. - Njoftimi i menjëhershëm i automjeteve dhe njërive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj). - Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim. | |
| Administrim | <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë, zones, instalimeve, infrastrukturës dhe mjeteve të përshkuara më sipër. | |

Raportimi i masa të ndërmarra për programin e përmirësimit të operimit

Raportimi i masave që do të ndërmerren në objektin ku ndodhet aktiviteti për trajtimin, konservimin, paketimin dhe magazinimin e peshqvedhe produkteve të tjera të detit, do të kryhet nga subjekti “**Nettuno**” Shpk, sipas një kalendari dhe regjistri të veçantë, i cili do të plotësohet nga drejtuesi teknik i punës në impiant dhe do të raportohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me miratimin e Përfaqësuesit Ligjor, Z. Salvatore Orlando.

Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruara në këtë Formular-Kërkese për tu paisur me Leje Mjedisore Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrfikëset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.

- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga zhvillimi i aktivitetit.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshem si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike, kjo do të coj në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianti me eficientë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes se tokes qe disponon ne pronesi/qera.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe eficientës që kanë në kryerjen e operacioneve per trajtimin dhe magazinimin e peshqve dhe produkteve te tjera te detit.
- Maksimizimi i perdorimit te lendes se pare
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të brendshem te kanalizimeve të ujrave teknologjike.
- Rrjeti elektrike është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Zona ku do të realizohen proceset e trajtimit dhe magazinimin e peshqve eshte e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksave, etj.
- Eshte ndertuar sistemi i brendshem i kanalizimeve te ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Për të shmangur ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga Ujërave të Ndotura Urbane të kësaj zone eshte realizuar lidhja me vaskat e dekantimit te cilat bëjnë dekantimin e ujrave të ndotura teknologjike. Ujrat grumbullohen nëpërmjet sistemit të drenazhimit i cili e përshkon të gjithë sipërfaqen e objektit ku janë të instaluar puseta e kontrollit dhe me rrjedhje të lire ujrat drejtohen për nga puseta dhe me pas ne vasken e dekantimit dhe me pas shkarkohen brenda normave ne kanalizimet e zones.
- Ndërsa në lidhje në burimet e furnizimit me ujë, jane të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në menyrë që të jetë i mjaftueshëm për të

- shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në aktivitetin për trajtimin dhe magazinimin e peshqve.
 - Menaxhim i integruar i mbetjeve të ngurta të gjeneruara nga vaskat e dekantimit
 - Trajtimi në mënyrë të integruar i ujërave të përdorur, para shkarkimit të tyre në mjedisin e zonës. Ky trajtim të kryhet nepermjet impianteve bashkekohore dhe të mirembahet vazhdimisht nga projektuesit dhe specialistet perkates.
 - Magazinimi dhe ruajtja e lëndës së pare të realizohet në kushte të larta higjienike dhe në ambiente frigoriferike.
 - Subjekti pas paisjes me leje mjedisore të tipit B me kodin III.1.B, duhet të jete në dijeni në kushteve të lejes dhe të detyrimeve ligjore që lindin, si dhe të zbatoje kushtet që do të paraqiten në lejen mjedisore.
 - Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurte ose e lenget në mjedisin ujor dhe atë tokësor të zonës pa u trajtuar me pare.
 - Të mos depozitohen mbetje në mjediset jashtë objektit dhe të mos tejkalohet kapaciteti magazinues i pershtatshem për mjediset e kapanonit
 - Të zbatohet dhe mirembahet me rigorozitet projekti i mbrojtjes nga zjarri në objekt, duke i kushtuar një rëndësi të vecante, jo vetëm ndertimit të sistemit, por edhe për zbatimin e kushteve teknike në ambientin e punës.
 - Të kryhet rregullisht dhe në mënyrë periodike monitorimi i treguesve mjedisor për të shmangur tejkalim të normave të lejuara me ligj të shkarkimit për këto veprimtari. Monitorimi dhe analizat e elementeve mjedisore kryhen nga laboratore publik dhe privat të licensuar dhe akredituar për këto lloj sherbimi.
 - Mirembajta dhe gjelberimi në mënyrë të vazhdueshem të mjedisëve përreth aktivitetit duke krijuar një imazh të kendshem të ambientit.
 - Subjekti të jete në dijeni të kuadrit ligjor për mjedisin dhe të ndryshimeve të tij.
 - Subjekti të hartojë një regjister të vecante për regjistrimin e sasise së mbetjeve të gjeneruara, trajtuara, ose asgjesuara nepermjet procesit të trajtimit dhe të raportoje rregullisht pranë Agjencise Kombetare të Mjedisit për këte.

- MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për aktivitetin është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit.

- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku zhvillohet aktiviteti dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me aktivitetin e Trajtimit, Konservimit, Paketimit dhe magazinimit të peshqve dhe produkteve të tjera të detit, i pozicionuar në Lushnjë nevojitet një monitorim i vazhdueshëm.

Plani i monitorimit do të konsistojë në :

- Monitorimi i parametrevë gjeometrike të instalimeve.
- Monitorimi i sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrja e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura teknologjike që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i operimit të punës në objekt

MONITORIMI DHE REKOMANDIME

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore.

Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse.

Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohet nga institucionet administrative si AKM-ja, ISHMPUT dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit etj.

PLANI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.

Meqenëse kemi të bëjmë me aktivitetin e trajtimit, konservimit, paketimit dhe magazinimit të peshqve, shkarkime të ujrave teknologjike, i zhurmës megjithëse në kemi thënë më lart që janë minimale.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor:

| <i>Nr</i> | <i>Elementi i Monitorimit</i> | <i>Frekuenca</i> | <i>Analiza</i> | <i>Përgjegjësi</i> |
|-----------|--------------------------------|------------------|------------------------|--------------------|
| 1 | Monitorim i gjithë shkarkimeve | Periodike | pH, lëndet në pezulli, | “Nettuno”Shpk |

| | | | | |
|---|---|-------------|---|---------------|
| | të ujrave që shkarkohen nga aktiviteti | | BOD5, COD, | |
| 3 | Monitorim i gazeve nga mjetet e transportit | Vazhdueshem | NO _x , SO _x , CO, CO ₂ , O | “Nettuno”Shpk |
| 4 | Monitorim i gjendjes së mekanikës dhe mundësisë për shtimin e zhurmave në punë. | Vazhdueshëm | Aromat, temperature, pluhurat, Zhurmat dB(A) | “Nettuno”Shpk |
| 5 | Monitorimin e aromave | Periodike | | “Nettuno”Shpk |

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron zbatimi i këtij projekti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të projektit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm është bërë konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.

Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zëvendësimin me fidanë të rinj.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjedisëve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”

Investitori do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis vetëm gjatë fazës së funksionimit dhe konkretisht elementët e mëposhtëm:

- Per ajrin duhet te monitoroje emetimet e zhurmave ne decibel (dB).
- Per ujin, te monitoroje permbajtjen e lendes ne pezulli, Nevojen Kimike per Oksigjen, Nevojen Biologjike per Oksigjen, yndyrnat, Pehashin, etj
- Per token, duke qene se nuk do te kete shkarkime, nuk aplikohen detyrime

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit dhe në rast të kundert, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre ose gjashtë muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto, masat e marra për reduktimin e ndotjes në mjedis dhe menyrën e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.

Regjistimi i të dhënave mjedisore

Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçantë ku do të pasqyrhen të gjitha parametrat e monitoruar nga subjekti “**Nettuno**”Shpk”, mirëmbajtja dhe përditësimin e regjistrit nga drejtuesi teknik i instalimit.

f. KONSULTIMET NDERKUFITARE

Zona ku zhvillohet do të zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojë të nënshtrohet procesit të konsultimit nderkufitar.

g. AUTORITETI VENDIMARRES PËR DHENIEN E AKTIT TË MIRATIMIT TË LEJES SË MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QË NDIQEN.

Autoriteti miratues është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos për miratimin apo refuzimin e aplikimit për tu pajisur me leje mjedisit të tipi B, me propozim nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacionin e paraqitur nëpërmjet Qendres Kombëtare të Biznesit.

Afati për marrjen në shqyrtim të aplikimit për pajisjen me leje mjedisit të tipit B është 40 ditë pune.

h. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TË DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NË FORME ELEKTRONIKE, BRENDË 20 DITË NGA DATA E NJOFTIMIT.

Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit: akm.gov.al